



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:077868
Datë: 24.05.2024
Numri i dokumentit: 05729079

PAKR.nr.235/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti i Krimeve të Rënda, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar kolegj, Afërdita Bytyçi dhe Hashim Çollaku, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Fitore Batatina, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.Sh. nga P., për shkak të veprës penale, Blerja, posedimi, shpërndarja apo shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 267 par. 2, lidhur me nenin 275 par. 1 nën par. 1.8 të KPRK-së, dhe të akuzuarit V.S. për shkak të veprës penale, Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2, lidhur me nenin 275 par. 1, nënpar. 1.8 të KPRK-së, duke vendosur në lidhje me ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit E.Sh., av. M.K.L. dhe ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit V.S. av. P.U., të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.98/2022, datë 07.03.2024, në seancën e kolegjit me datë 16.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit E.Sh. av. M.K.L. dhe ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit V.S. av. P.U. ndërsa aktgjyqimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.98/2022, datë 07.03.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin, PKR.nr.98/2022, datë 07.03.2024, të akuzuarin E.Sh. e ka shpallur fajtor për veprën penale, Blerja, posedimi, shpërndarja apo shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 267 par. 2, lidhur me nenin 275 par. 1 nënpar. 1.8 të KPRK-së, dhe të akuzuarin V.S. e ka shpallur fajtor për veprën penale, Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2, lidhur me nenin 275 par. 1, nënpar. 1.8 të KPRK-së, dhe i ka gjykua si në vijim:

Të akuzuarin E.Sh. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti e gjashtë (6) muaj, i cili dënim do të ekzekutuar menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe me dënim me gjobë në shumen prej treqind (300) euro, të cilin dënim i njëjti është obliguar t'a paguaje në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I akuzuari V.S. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti e tre (3) muaj i cili dënim do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe me dënim me gjobë në shumen prej treqind (300) euro, e të cilin dënim i njëjti është obliguar t'a paguaje në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse të akuzuarit dështojnë, refuzojnë apo nuk paguajnë dënimet e shqiptuara me gjobë në afatin e caktuar, të njëjtat do t'iu zëvendësohen në dënim burgimi duke i'u llogaritur një ditë burgimi shumen prej 20 (njëzetë) euro

Të akuzuarit janë obliguar që secili veç e veç t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale në formën e paushallit gjyqësor në shumën prej nga pesëdhjetë (50) euro, si dhe shumën prej pesëdhjetë (50) euro, për taksën për kompensimin e viktimave të krimit në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditës nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

Në kuptim të nenit 267 par. 5, 269 par. 3 të KPRK-së, lidhur me nenin 276 par. 1 dhe 2 nën par. 2.4 të KPPRK-së, është urdhëruar konfiskimi i substancës narkotike e llojit marihuanë, dhe shkatërrimi i saj menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi kanë parashtruar ankesë:

Mbrojtësja e të akuzuarit E.Sh. av. M.K.L. për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata Apelit e Kosovës, aktgjykimin e ankimuar t'a ndryshoj ashtu që të akuzuarit E.Sh. t'ia zbus dënimin duke i shqiptuar një dënim dukshëm më të ulët me burg dhe më gjorbë.

Mbrojtësja e të akuzuarit V.S. av. P.U. për shkak të vendimit mbi dënim, me propozim që Gjykata Apelit e Kosovës, aktgjykimin e ankimuar t'a ndryshoj ashtu që të akuzuarit V.S. t'i shqiptoj një dënim më i butë apo i kushtëzuar.

Prokurori i Apelit me parashtresën më shkrim, PPA/I.nr.220/2024, të datës 19.04.2024, ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtëses se të akuzuarit E.Sh. av. M.K.L. dhe ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit V.S. av. P.U. ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.98/2022, datë 07.03.2024, të vërtetohet.

Konform nenit 390 par.1 të KPPK-së, u caktua dhe u mbajt seanca e kolegjit në të cilën prezantuan: i akuzuari E.Sh. dhe mbrojtësja e tij, av. M.K. si dhe i akuzuari V.S. ndërsa nuk prezantoi mbrojtësja e të akuzuarit V.S. av.P.U. dhe as Prokurori i Prokurorisë së Apelit, edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës, andaj, seanca e kolegjit u mbajt konform nenit 390 par. 4 të KPPK-së, në mungesë të tyre. Në seancë mbrojtësja e të akuzuarit E.Sh. av. M.K. pasi elaboroj pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, mbeti pranë propozimit që aktgjykimi i ankimuar të ndryshoj dhe të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më i butë, duke i marrë parasysh faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor. I akuzuari E.Sh. deklarojë se pajtohet në tërësi me mbrojtësen e vet. I akuzuari V.S. deklarojë se ngelet pranë pretendimeve të mbrojtëses se tij të paraqitura në ankesë, dhe propozimit që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që dënimi i shqiptuar t'i zbutet.

Gjykata e Apelit pasi që ka studiuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarve, propozimin e Prokurorisë së Apelit, dhe duke analizuar shkresat e

lëndës në këtë çështje penale në vështrim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Pretendimet ankimore të mbrojtëses se të akuzuarit

Mbrojtësi i të akuzuarit E.Sh. av. M.K.L. në ankesë pretendon se i akuzuari ka bërë pranimin e fajësisë për veprën për të cilën është shpallur fajtor më aktgjykimin e ankimuar. Gjykata e shkallës së parë si rrethana lehtësuese përveç pranimit të fajësisë ka marrë si rrethanë lehtësuese edhe faktin se i akuzuari përveç tjerash ka shpreh pendimin dhe keqardhjen në lidhje me veprën penale. I akuzuari E.Sh. i cili është në vuajtje të dënimit tani e një kohë, e që ky dënim vazhdon deri në vitin 2029, me shumë bindje them se veprat penale për të cilat akuzohet të gjitha kanë qenë vepra penale vjedhje dhe se asnjë nga veprat e kryera nga i njëjti nuk kanë të bëjnë me veprën penale tani për të cilën me aktgjykimin e ankimuar është shpallur fajtor dhe duke u nisur nga ky fakt, pranimin e fajësisë dhe veprën e parë për të cilën akuzohet, gjykata e shkallës së parë, si rrethanë rënduese e ka marrë shkallën e lartë të dashjes nga ana e të akuzuarit nga fakti se veprën penale e ka kryer me dashje, e që kjo rrethanë konsideron se nga ana e gjykatës shkallës së parë është mbivlerësuar. Një konstatim i tillë i gjykatës është jo real dhe pak sa i mbivlerësuar, ngase për të akuzuarin E.Sh. kjo është vepra e parë e këtij lloji, se i akuzuari më shumë keqardhje ka treguar që këtë vepër e ka bërë nga budallakia e tij, e duke mos i menduar fare pasojat si dhe duke mos e menduar faktin që tani është në vuajtje dhe për këtë arsye ka shprehur edhe kërkim faljen e tij të thellë dhe keqardhjen, duke kërkuar që gjykata t'i shqiptoj një dënim të butë, e që marr parasysh edhe moshën e tij të re dhe kohën që i njëjti do të kaloj në vuajtje dhe dënimin plotësues që gjykata ka shqiptuar ndaj të njëjtit.

Pretendimet ankimore të mbrojtëses se të akuzuarit

Mbrojtësi i të akuzuarit V.S. av. P.U. në ankesë thekson se duke u mbështetur në nenin 383 par. 1 pika 1.4 të KPPK-së, aktgjykimin e ankimuar e kundërshton për shkak të lartësisë së dënimit duke konsideruar se ndaj të akuzuarit V.S. është shqiptuar dënim i lartë. Konsideron se është dënimi i lartë ngase i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën e kryer, dhe se duhet të merret parasysh edhe gjendja emocionale, familjare dhe rrethanat tjera që kanë shtyer të akuzuarin t'a kryej veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, pastaj pendimi i tij për kryerjen e veprës penale. Andaj, kërkon nga kolegji i Gjykatës së Apelit që pas shqyrtimit të ankesës dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës duke vepruar në bazë të nenit 398 par. 1, pika 1.4 të KPPK-së,

të bëjë ndryshimin e aktgjykimit të ankimuar ashtu që të akuzuarit ti shqiptoj një dënim me të butë.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë edhe pse me ankesë nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi në këtë aspekt – konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së, dhe konstatoi se nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat kishin më kushtëzuar anulimin e tij, dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarve.

Po ashtu, me ankesë nuk kontestohet as gjendja faktike të cilën e ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë, prandaj në këtë aspekt çështja nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate (në fakt as që ka mund të kontestohet aktgjykimi përkitazi me ketë bazë ankimore ngase të akuzuarit kanë pranuar fajësinë), kurse aktgjykimi u vlerësua vetëm në frymë të pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënim, Gjykata Apelit, gjen se pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarve për zbutje të dënimit, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që në raport me të akuzuarin E.Sh. si rrethanë posaçërisht lehtësuese ka gjetur pranimin e fajësisë, pendimin dhe keqardhjen e shprehur gjatë seancës për veprimet e tij, ndërsa si rrethana rënduese ka gjetur shkallën e lartë të dashjes së të akuzuarit në kryerjen e veprës penale, faktin se i njëjti edhe më parë ka qenë i dënuar për vepra penale dhe gjendet në vuajtje të dënimit, dhe se fakti që është në vuajtje të dënimit në Qendrën Korrektuese nuk e ka ndaluar që prapë të kryejë veprime të kundërligjshme. Po ashtu, gjykata i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit edhe në raport me të akuzuarin V.S. ku si rrethana posaçërisht lehtësuese gjeti pranimin e fajësisë nga ana e të njëjtit, pendimin dhe keqardhjen e shprehur gjatë seancës për veprimet e tij, ndërsa si rrethana rënduese gjeti shkallën e lartë të dashjes së të njëjtit në kryerjen e veprës penale pasi që me çdo kusht ka dashur të fsheh narkotikun i cili është objekt i veprës penale, dhe të njëjtin e ka fshehur në zgavrën e gojës, si dhe faktin së i njëjti edhe më parë ka qenë i dënuar për vepra penale dhe gjendet në vuajtje të dënimit, dhe së fakti që është në vuajtje të dënimit në Qendrën Korrektuese nuk e ka ndaluar që prapë të kryejë veprime të kundërligjshme. Andaj, gjykata duke u gjendur

para këtyre rrethanave të akuzuarit i gjykoi si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar duke konsideruar se dënimet e shqiptuara ndaj tyre janë në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tyre dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarve në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KRPK-së.

Me rastin e shqiptimit të dënimit, e duke pas parasysh rrethanat e sipër cekura, dhe atë në raport me dy të akuzuarit, e posaçërisht faktin së të akuzuarit kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat janë akuzuar, dhe se kanë shprehur pendimin dhe keqardhjen për veprat e kryera, gjykata duke pas parasysh edhe dënueshmërinë për këto vepra penale e që sipas nenit 275 par. 1 të Kodit Penal është dënimi me gjobë dhe me burgim prej tri (3) deri në pesëmbëdhjete (15) vjet, ka aplikuar dispozitat të cilat kanë të bëjnë me zbutjen e dënimit, respektivisht nenin 71 par. 1 nën par. 1.3 e lidhur me nenin 72 të KPRK-së, ashtu që duke vepruar konform dispozitave ligjore të nenit 71 dhe 72 par. 1, nën par. 1.3 të KPRK-së, ku përcaktohet se, *“nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej së paku tre (3) vjet, dënimi mund të zbutet deri në një (1) vit burgim;”*, gjykata të njëjtëve u ka shqiptuar dënimin me burgim nën minimum të parapare ligjor në aplikim të këtyre dispozitave, respektivisht dënimet me burgim si në pikën I dhe II të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar.

Një vlerësim të tillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo Gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa rrethanat e pretenduara në ankesën e mbrojtësve të akuzuarve si: kërkim faljen, shprehja e keqardhjes për veprën e kryer, gjendja emocionale dhe familjare, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate nuk janë të asaj natyre dhe nuk kanë ndikim që të akuzuarve t’iu shqiptohen dënime tjera nga ato të cilat u ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, andaj, të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj Gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimeve nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarve nga ana e gjykatës së shkallës së parë janë në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprave të kryera penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve si ekzekutor, dhe me intensitetin e

rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se me to do të mund të parandalohen të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmën, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga arsyet e sipërcekura, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për Krime të Rënda
PAKR.nr.235/2024, datë 16.05.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale

Kryetari i kolegjit

Fitore Batatina

Xhevdet Abazi

Anëtarët e kolegjit:

Afërdita Bytyçi

Hashim Çollaku